

Nr. Prot 37

Dt. 14.01.2025

Ndërmarrje e Punëve Publike



Ndërmarrje e Gjellb
Shërbimeve

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER**

Drejtoria e Programimit, Kontrollit të Punëve Publike dhe Investimeve

Nr. 341 Prot.

Fier, më 13.01.2025

Lënda: Përcjellje e specifikimeve teknike për pllaka betoni për shërbime funerale.

**Ndërmarrjes së Shërbimeve të Gjellbërimit, Higjenës dhe
Mirëmbajtjes së Varrezave Publike Fier**

Në përgjigje të kërkesës Tuaj me nr.03 Prot., datë 06.01.2025, protokolluar pranë Bashkisë Fier me nr. 34, datë 06.01.2025, lidhur me specifikimet teknike për objektin 'Blerje pllaka betoni për shërbime funerale', bashkëlidhur kësaj shkrese po ju dërgojmë:

1. Treguesit teknikë të pllakave (hermetik dhe provizore) për të rritur dhe të vegjël.
2. Specifikimet teknike lidhur me punimet e betonit dhe hekurit

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

**KRYETARI
Armando SUBASHI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER

Drejtoria e Programimit, Kontrollit të Punëve Publike dhe Investimeve

TREGUESIT TEKNIK TË PLLAKAVE B/A PËR SHËRBIME FUNERALE

TIPI I PRODHIMIT TË PLLAKAVE	LLOJI I PRODHIMIT	PËRSHKRIMI	SASIA (COPE)	DIMENSIONET (CM)	TRASHËSIA (CM)
Pllakë për shërbim funerale/ Tipi T 1 komplet	Hermetik për të rritur	Pllaka anësore	4	60 x 105	5
		Pllaka ballore	2	60 x 80	5
		Kapak	5	44 x 80	5
	Provizore për të rritur	Bordura b/a	2	27 x 175	5
		Pllaka Ballore	1	27 x 65	5
		Pllaka fundore	1	20 x 65	5
Pllakë për shërbim funerale / Tipi T 2 komplet	Hermetik për të vegjël	Pllaka anësore	4	60 x 70	5
		Pllaka ballore	2	60 x 50	5
		Kapak	4	38 x 50	5
	Provizore për të vegjël	Bordura b/a	2	27 x 120	5
		Pllaka ballore	1	27 x 40	5
		Pllaka fundore	1	20 x 40	5

Pllakat ballore dhe anësore do të prodhohen me Beton M-16/20.

Pllakat do të jenë të armuara me zgare Φ 6/15 cm.

Kapaket te pajisen me ganxha Φ 10 per montim.

Ing.L.Zeka

Ing.S.Basha

PUNIME BETONI DHE HEKURI

1. BETONI

1.1. Kërkesa të përgjithshme për betonet

Betoni është një përzierje e çimentos, inerte të fraksionuara të rërës, inerte të fraksionuara të zhavorit dhe ujit dhe solucioneve të ndryshme për fortësinë, përshkueshmërinë e ujit dhe për të bërë të mundur që të punohet edhe në temperatura të ulëta sipas kërkesave dhe nevojave teknike të projektit.

1.2. Materialet

Përbërësit e Betonit

Përbërësit e betonit duhet të përmbajnë rërë të larë ose granil, ose përzierje të të dyjave si dhe gurë të thyer. Të gjithë agregatët duhet të jenë pastruar nga mbeturinat organike si dhe nga dheu. Pjesa kryesore e agregateve duhet të jetë me formë këndore dhe jo të rrumbullakët. Përbërësit e betonit duhet të kenë çertifikatën që vërteton vendin ku janë marrë ato.

- Çimento

Kontraktuesi është i detyruar që për çdo ngarkesë çimentoje të prurë në objekt, të paraqesë faturën e blerjes e cila të përmbajë: sasinë, emrin e prodhuesit si dhe çertifikatën e prodhuesit dhe shërben për të treguar që çimentoja e secilës ngarkesë është e kontrolluar dhe me analiza sipas standarteve.

Për më shumë detaje në lidhje me markën e çimentos që duhet përdorur në prodhimin e betoneve, shiko në pikën 1.3, pasi për marka betoni të ndryshme duhen përdorur marka çimento të ndryshme.

- Uji për beton

Uji që do të përdoret në prodhimin e betonit duhet të jetë i pastër nga substancat që dëmtojnë atë si: acidet, alkalidet, argila, vajra si dhe substanca të tjera organike. Në përgjithësi, uji i tubacioneve të furnizimit të popullsisë (uji i pijshëm) rekomandohet për përdorim në prodhimin e betonit.

1.3. Klasifikimi i betonit

Beton klasa C-16/20 me inerte:

Çimento R32.5- 300 kg, rërë e larë me modul 2,6 - 0,43 m³, granil deri në 15 mm - 0,69 m³, ujë - 0,18 m³.

- **Karakteristikat mekanike:**

- Peshë Specifike:	25000 N/m ³
- Koeficienti i zgjerimit termik:	0.000010 1/°C
- Moduli i elasticitetit normal:	28821 N/mm ²
- Moduli i elasticitetit tangencial:	12009 N/mm ²
- Rezistenca karakteristike kubike:	20.00 N/mm ²
- Rezistenca llogaritese në shtypje:	9.41 N/mm ²
- Rezistenca llogaritese në terheqje:	0.91 N/mm ²
- Rezistenca mesatare në terheqje nga perkulja:	2.24 N/mm ²

- **Te dhënat e projektimit të betonit:**

- Klasa e Betonit:	C-16/20
- Klasa e Ekspozimit:	XC1
- Klasa e Konsistencës:	S4
- Raporti Ujë/Çimento:	≥0,5 (max 180 l/m ³)
- Çimento:	min 300 kg/m ³
- Diametri i Inerteve	max 15mm

1.4. Prodhim i betonit

Betoni duhet të përgatitet për markën e përcaktuar nga projektuesi dhe receptura e përzierjes së materialeve sipas saj në mbështetje të rregullave që jepen në KTZ 37 – 75 "Projektim i betoneve". Gjatë përgatitjes së betonit të zbatohen rregullat që jepen në kapitullin 6 "Përgatitja e betonit" të KTZ 10/1-78, paragrafët 6.2, 6.3 dhe 6.4.

1.5. Hedhja e betonit

Hedhja e betonit të prodhuar në vend bëhet sipas mundësive dhe kushteve ku ai do të hidhet.

E rëndësishme në procesin e hedhjes së betonit në vepër është koha nga prodhimi në hedhje, e cila duhet të jetë sa më e shkurtër.

Gjithashtu, një rëndësi të veçantë në hedhjen e betonit ka edhe vibrimi sa më mirë gjatë këtij procesi.

1.6. Mbrojtja e betonit

Betoni i freskët duhet mbrojtur nga këto ndikime:

- Shiu si dhe lagështi të tjera duke e mbuluar sipërfaqen e betonuar me plastmas dhe materiale të padepërtueshme nga uji
- Ngricat (duke i futur gjatë procesit të prodhimit solucione kundra temperaturave të ulta mundet të betonohet deri në temperatura afër zeros.
- Temperatura të larta. Betoni mbrohet ndaj temperaturave të larta duke e lagur vazhdimisht atë me ujë, në mënyrë të tillë që të mos krijohen plasaritje.

1.7. Betonimi ne kushte te veshtira atmosferike

Rekomandohet që prodhimi dhe hedhja e betonit në objekt të mos realizohet në kushte të vështira atmosferike.

Ndalohet prodhimi dhe hedhja e betonit në rast se bie shi i rrëmbyeshëm, pasi nga sasia e madhe e ujit që i futet betonit largohet çimentoja dhe kështu që betoni e humb markën që kërkohet.

Në rastet e temperaturave të ulta nën 4 °C rekomandohet të mos kryhet betonimi, por n.q.s kjo është e domosdoshme, atëherë duhet të merren masa që gjatë procesit të prodhimit të betonit, atij t'i shtohet solucionin ndaj ngricave në masën e nevojshme që rekomandohet nga prodhuesi i këtij solucion.

Prodhiimi dhe përpunimi i betonit në temperatura të larta mund të ndikojë negativisht në reagimin kimik të çimentos me pjesët e tjera të betonit. Për këtë arsye ai duhet ruajtur kundër

temperaturave të larta. Mënyra e ruajtjes nga temperatura e lartë mund të bëhet në atë mënyrë, që betoni i freskët të mbrohet nga dielli duke e mbuluar me plasmas, tallash dhe

duke e stërkatur me ujë. Një ndihmë tjetër për përpunimin e betonit në temperatura të larta është të ngjyrosësh mbajtësit e ujit me ngjyrë të bardhë dhe të sigurojë spërkatje të vazhdueshme me ujë.

2. ÇELIKU

2.1 Karakteristikat mekanike:

- Peshë Specifike:	78500 N/m ³
- Koeficienti i zgjerimit termik:	0.000010 1/°C
- Moduli i elasticitetit normal:	210000 N/mm ²
- Moduli i elasticitetit tangencial:	80769 N/mm ²
- Rezistenca karakteristike në rrjedhshmeri	450.00 N/mm ²
- Resistenca llogaritese	391.30 N/mm ²

2.2 Kthimi i hekurit

- Hekurat duhen kthyer sipas dimensioneve të treguara në projekt.
- Përveç pjesës së lejuar më poshtë, të gjitha shufrat duhen kthyer dhe kthimi duhet bërë ngadalë, drejt dhe pa ushtrim force. Bashkimet e nxehta nuk lejohen.
- Prerja me oksigjen e shufrave shumë të tendosshme do të lejohet vetëm me aprovimin e Supervizorit. Shufrat e ambalazhimit nuk mund të drejtohen dhe të përdoren.

2.3 Mbulimi i hekurit

Termi mbulimi në këtë rast do të thotë minimumin e pastër të shtresës mbrojtëse ndërmjet sipërfaqes së hekurave dhe faqes së betonit.


Mbulimi minimal do të bëhet sipas normave të KTZ

2.4 Drejtimi i hekurit

Një pjesë e hekurit (me diametër më të vogël se 8 mm) transportohet në formë rrotullash. Për këtë, duhet që ai të drejtohet në kantierin e ndërtimit. Drejtimi i tij kryhet me metoda praktike si psh. lidhja e njërës anë në një pikë fikse dhe tërheqja e anës tjetër me mekanizma të ndryshme. Ky proces pune duhet të kryhet me kujdes dhe nën vëzhgimin e drejtuesit të punimeve.

Konceptoi:

Ing. Ludmilla Zeka



Ing. Silvana Basha

